

KLASA 9

1. Lexo vargjet e Ali Asllanit: “E na tunde, na lëkunde, nëpër salla shkon e shkundet, / mbasi dora e armikut ty me shok` të heq prej hunde.”

- Fjalët e nënvizuara janë: A) trajta të shkurtra
B) trajta të shkurtra të bashkuara C) pasthirrma
D) pjesëza E) përemra vetorë

2. Në vargjet e Migjenit: “...ndër lufta të reja kemi m`u ndeshë / dhe për fitore kem` me ra fli...”, folja kallëzues është në kohën: A) e tashme të kushtores
B) e ardhme të dëftores C) e pakryera e dëftores
D) asnjë nga këto

3. Në fjalinë “Në luajtë mirë sot ai, skuadra fiton patjetër”, folja e nënvizuar është në kohën: A) e tashme e kushtores B) e pakryer e dëftores
C) e tashme e dëshirores D) e pakryer e lidhores
E) asnjë nga këto

4. “A e dini që fitimi brenda katër vjet mizor` / nuk është` yti, nuk është` imi, është` i kombit arbëror, / Është` i syrit në lot mekur, është` i vendit djegur, pjekur, / Ju do thoni si të doni... po e drejta dërrmon hekur!”
Në vargjet e mësipërme të poetit Ali Asllanit kemi:
A) 5 kallëzues emërorë + 4 kallëzues të thjeshtë foljor
B) 4 kallëzues emërorë + 3 kallëzues foljor të thjeshtë + 3 kallëzues të përbërë
C) 4 kallëzues emërorë + 4 kallëzues të thjeshtë foljor + 1 kallëzues të përbërë
D) asnjë nga këto më sipër

5. Cili është kuptimi i vargjeve të pyetjes 4?
A) Njeriut i duhen katër vjet për t`u pasuruar.
B) Katër vjet vështirësish sjellin fitime të mëdha.
C) Fitimi i pushtetarëve në katër vjet të mandatit qeverisës vjen nga shfrytëzimi barbar i popullit dhe vendit. D) Të gjitha këto më sipër. E) Asnjë nga këto.

6. Në vargjet “Që të zinit një kolltuk, aq u ulët, u përkulët, / sa në pragun e armikut vajtët si kopil u ngulët!”, foljet e nënvizuara janë në diatezën:

A) veprorë B) pësore C) vetvetore D) mesore

TEZË SHEMBULL

7. Në vargun “ ... ma hodhi në baltë nderë..”, shprehja frazeologjike mund të zëvendësohet me një:
A) emër B) mbiemër C) folje
D) ndajfolje E) asnjë nga këto

8. Në vargjet “Na të birtë e shekullit të ri, / vllazën të lindun e të rritun në zi, / kur tingëlloi çasti ynë i mbramë/ edhe fatlumë ditëm me thanë ..!”, (Migjeni) grupet e fjalëve të nënvizuara janë:
A) kallëzuesorë të veçuar
B) rrethatorë të veçuar C) përcaktorë të veçuar
D) ndajshitime të veçuara E) kryefjalë homogjene

9. “Vetëm, vetëm dallavera, dhe në dëm të këtij vendi / që ju rriti, që ju ngriti, që ju ngopi, që ju dëndi!”
- Në vargjet e mësipërme ndodhen:
A) 4 pjesëza saktësuese
B) 3 pjesëza përforcuese dhe 1 saktësuese
C) 3 pjesëza saktësuese dhe një përafuese
D) 3 pjesëza përforcuese dhe 4 pjesëza saktësuese
E) 3 pjesëza përforcuese

10. Në vargjet: “Lum nana që t`ka / bir t`ka e të pastë, / me të mira prapa të lantë!”, fjala e nënvizuar është: A) mbiemër B) ndajfolje C) pasthirrmë
D) emër E) folje

11. Cila është forma e saktë? A) Siqeli B) Siçili
C) Sicili D) asnjëra E) të gjitha

12. Cila nga fjalitë ka diçka të shkruar gabim?
A) Vallet e krahinës së Shkodrës, të Elbasanit, të Korçës e Myzeqesë janë të pëlqyera. B) Kjo është një gjë e zakonshme për darkën e së dielave. C) U besonte verbërisht fjalëve të së ëmës. D) Asnjë nga fjalitë nuk ka gabim.

13. Sa prej fjalëve të mëposhtme janë shkruar gabim? e një të sotme, mbrapsht, lightë, njëzetë, gjysmë, dembela, thyeva, kam zier, e dielë, dhjetëra, i paktë
A) 3 B) 4 C) 5 D) 6 E) 9

14. Kur shkrimtarët pjesët e tyre letrare i përshkruajnë nga tone polemike e ironizuese, përdorin:

A) . (pikën) B) : (dy pika) C) ? (pikëpyetjen)
D) ! (pikëçuditjen) E) ... (tri pika)

15. “Thonë u shtri e thonë u vra, / por ti s’vdiqe or baba, / as te Shpella e Dragobisë, / as te zemra e djalërisë!” - Në vargjet e Fan Nolit kemi:

- A) 2 pjesë kryesore me vetë të përcaktuar
- B) 1 me vetë të përcaktuar, 1 me vetë të përgjithësuar, 1 me vetë të papërcaktuar
- C) 2 pjesë kryesore me vetë të papërcaktuar dhe 1 me vetë të përcaktuar
- D) 1 pjesë kryesore me vetë të papërcaktuar dhe 1 me vetë të përcaktuar
- E) asnjë nga këto më sipër


16. “Qenka një në botë, s’paskërka të dytë, / ç’na shëroka plagët, ç’na shëroka sytë!”, fjalia e nënvizuar është:

- A) emërore
- B) foljore vetore
- C) dykryegjymtyrëshe
- D) foljore pavetore
- E) foljore njëvetore

17. Në cilën nga fjalitë me gjymtyrë homogjene ka gabim?

- A) Hani, pini e rrëmbeni, është bot` e maskarenjve!
- B) Dashuria e Bukuria bashkë të dyja u bënë.
- C) Mëshira hyjnore është e thellë dhe e gjerë.
- D) Ose ata, ose ai do ta mbajnë këtë përgjegjësi.

18. “Shpesh – hera, mallëngjyeshëm zani i msuesit, na thonte se jeta a plot mashtrime e se të shumtën ndodh që n`udha t`saja i drejti vuen edhe ngadhnjen bakeqi.” Cila është skema e varësisë së pjesëve të kësaj fjalie?



19. Ç`lloj fjalie është “Dituria në jetë është siç është arma në luftë”?

- A) fjali e thjeshtë me kallëzues emëror
- B) fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur mënyrore
- C) fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur kryefjalore
- D) fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur kallëzuesore
- E) fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur krahasore

20. Kur e shkroi Gjon Buzuku veprën “Meshari”?

- A) 5 mars 1554 deri më 20 dhjetor 1555
- B) 15 prill 1550 deri më 5 dhjetor 1555
- C) 20 mars 1554 deri më 5 dhjetor 1555
- D) asnjë nga këto

21. Në fjalinë “I shkoi një gjilpërë fundit të fustanit”, kuptimi i figurshëm i fjalës gjilpërë ka lindur duke u mbështetur:

- A) në ngjashmërinë e sendeve sipas një tipari të jashtëm
- B) në afrinë në kohë të sendeve e dukurive
- C) në përmbajtjen e sendit
- D) në lëndën e përbashkët
- E) në zëvendësimin e veprimit

22. “Fjalori i gjuhës shqipe” i vitit 2006 përmban:

- A) 4200 fjalë
- B) 4600 fjalë
- C) 4800 fjalë
- D) 5800 fjalë
- E) asnjë nga këto

23. Sipas veçorive gjuhësore tekstet i klasifikojmë në:

- A) 6 lloje
- B) 8 lloje
- C) 10 lloje
- D) 7 lloje
- E) asnjë nga këto

24. Në një vepër letrare, koha që i bën ngjarjet, kujtimet e së kaluarës më të gjalla, më të afërta, quhet:

- A) kohë historike
- B) e tashme historike
- C) kohë e brendshme
- D) asnjë nga këto

25. Shkrimtari që nuk e shkroi veprën e tij në Shqipëri ishte:

- A) Ndre Mjeda
- B) Migjeni
- C) Martin Camaj
- D) Kasëm Trebeshina
- E) Lasgush Poradeci

26. Nisur nga poezia e Ernest Koliqit “Kolegja”, vargu “... e kam ndërrue krejt ... un`qi desha t`ndroj botën!”, ndodhet:

- A) përpara tre vargjeve të fundit
- B) midis tre vargjeve të fundit
- C) është vargu i fundit
- D) në asnjë nga këto pozicione

27. Në vargjet “Po kur ngrihetë Nakari / me fytyrë të mërzhitur, / si i vdekuri nga varri / i tretur e i venitur”, figura kryesore e përdorur është:

- A) krahasimi
- B) metafora
- C) similituda
- D) epiteti
- E) similituda dhe epiteti metaforik

28. Në vargjet e Naimit “Atë, q` ishte trim e burrë! / S`e zij as ushta, as shpata / as shigjet` e luftës kurrë, / e shtu poshtë jetëgjata!”, cila ishte jetëgjata?

- A) vasha që e donte
- B) Dashuria
- C) dëshira për të jetuar
- D) Trimëria
- E) asnjë nga këto

29. Në vargjet e mësipërme, pjesa e nënrenditur lidhet me kryesoren me:

- A) lidhëz
- B) ndajfolje
- C) përemër lidhor
- D) me presje
- E) me intonacion

30. Në vargjet “Se sa t`enden stina e moti, / do t`a gzojn`kta djalë mbas djali”, pjesa e nënrenditur është:

- A) kohore
- B) sasiore
- C) mënyrore
- D) lejore
- E) rrjedhimore